



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Nr. 784/14 Prot.

Tiranë, më 30/11 /2017

V E N D I M

Nr. 165, Datë 30/11/ 2017

PËR

AUDITIMIN TEMATIK TË USHTRUAR
NË ISH MINISTRINË E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE
SIPËRMARRJES, "PËR PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES TË ZHVILLUESIT TË
ZONËS TEKNOLOGJIKE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK NË SPITALLË, DURRËS"

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit tematik "*Për procedurën e përzgjedhjes të zhvilluesit të zonës teknologjike të zhvillimit ekonomik në Spitalë, Durrës*" në ish Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, sipas Programi të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 784/1, datë 24.07.2017, i ndryshuar.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

Nga auditimi rezultoi se, në ligjin nr. 54/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9789, datë 19.07.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike” neni 10 germa “ b” është përcaktuar se “zhvilluesi merr në përdorim truallin për një periudhë kohore deri në 99 vjet dhe gëzon të drejtën e dhënies me nënqira të përdoruesit”. Po kështu, Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 262, datë 06.04.2016 “Për shpalljen e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në Spitalë, Durrës” neni 4 ka përcaktuar se “Periudha e funksionimit të zonës është deri në 99 vjet, nga dita e hytjes në fuqi e kontratës së lidhur me zhvilluesin. Nga ky përcaktim konstatohet se, kjo procedurë nuk konsiderohet as dhënie me qira dhe as koncesion pasi në ligjin nr. 9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike” neni 4 “Shpallja e zonave ekonomike” (zona Spitalë Durrës) pika 5, “Përzgjedhja e zhvilluesit të zonës ekonomike bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet” dhe të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” Kreu V “Kontrata me tarifën simbolike 1 euro kontrata”, për pasuritë me sipërfaqe mbi 500 m², u jepen të tretëve. Për sa më lart kjo procedurë konsiderohet një hibrid midis këtyre dy varianteve që nuk përcakton qartë në se, trualli dhe investimet e kryera në këtë zonë do të jenë të transferueshme në pronësi të shtetit, apo do të kenë alternativa të tjera për të gjitha kategoritë e procedurave të dhënies me qira sipas afatit të përcaktuar në dispozitat e mësipërme.

Për këtë rekomandoj:

Marrjen e masave, duke shtuar një nen të veçantë në ligjin nr. 54/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9789, datë 19.07.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”, ku të përcaktohet qartë nëse trualli dhe investimet e kryera në këtë zonë do të jenë të transferueshme në pronësi të shtetit, apo nëse për to parashikohen alternativa të tjera

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i procedurës së përzgjedhur për zhvillimin e zonës Spitalë, Durrës, nuk u gjend asnjë relacion apo raport përfundimtar, mbi zhvillimin e seancave informuese, apo diskutimeve dëgjuese me komunitetin e zonës, mbi rëndësinë e zhvillimit të saj, efektet e ndikimit mjedisor dhe social, që parashikon ky investim për ndërtimin e një fabrike Ferro-kromi. Për këtë projekt nuk është përgatitur asnjë relacion tekniko-ekonomik shoqëruar me risqet që mbart ky investim në ndotjen mjedisore dhe si pasojë nuk janë propozuar masat për monitorimin e vazhdueshëm, në çdo fazë të zhvillimit të këtij projekti. Sa më sipër merr rëndësi edhe në kuadër të promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së mjedisit, diktuar nga rekomandimet e Komisionit Evropian, në Progres Raportin për Shqipërinë, kapitulli 27¹, ku ndër të tjera parashikohen edhe masat që duhen marrë për zbatimin e Direktivave të BE-së në këtë fushë.

Për këtë rekomandoj:

Në të gjitha rastet e kryerjes së procedurave konkurruese që lidhen me përdorimin dhe shfrytëzimin e pronës publike, të bëhen studime të hollësishme nga specialiste të certifikuar

¹ SWD(2016) 364 final

(ekspertë fushe), me qëllim përcaktimin e kriterëve të përgjithshëm dhe të veçanta për vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe të impaktit ekonomik-social të investimit të parashikuar.

2. Nga auditimi mbi vlerësimin e KVO-së dhe të specialistëve të fushës u konstatuan të meta dhe mangësi e konkretisht:

2.1 Nga verifikimi i kryer në dosjen e kësaj procedure u konstatuan se **vlerësimet individuale, të kryera nga specialistët e fushës për kriteret respektive, nuk janë marrë në konsideratë nga KVO, duke ndryshuar padrejtësisht edhe rezultatin përfundimtar të operatorëve ekonomikë konkurrues, konkretisht:**

- Vlerësimi total, mbështetur mbi vlerësimet e pavarura të specialistëve të fushës për shoqërinë “Operatori 1” shpk duhej të ishte 80,18 pikë, dhe për shoqërinë “Operatori 2” duhej të ishte 70.81 pikë (ose 9.37 pikë më shumë për Operatorin 1); ndërsa,
- Vlerësimi total me pikë sipas raportit përfundimtar të KVO-së ka ndryshuar në 70.7 pikë për shoqërinë “Operatori 1” (ose 9.48 pikë më pak se vlerësimi i specialistëve), dhe 71.3 pikë për shoqërinë “Operatori 2” (ose 0.49 pikë më shumë nga vlerësimi i specialistëve), duke renditur në vend të parë Operatori 2 me 0.6 pikë më shumë nga shoqëria “Operatori 1”.

Tabela në vijim reflekton vlerësimet për secilin kriter nga KVO dhe nga specialistët e fushës:

Vlerësimet	Operatori 1 (1)	Operatori2 (2)
1	Propozimi teknik	
A (specialit, AIDA)	21,0	23,0
KVO	10,3	24,8
2	Ndikimi mjedisor	
B (specialit, Min. E Mjedisit)	4,0	10,0
KVO	4,7	9,7
3	Ndikimi social	
C (specialit, ATRAKO)	10,0	7,7
KVO	10,6	7,7
4	Koha e perfundimit	
D (specialist, MZHETS)	10	6,4
KVO	10	6,5
5	Kapaciteti financiar	
D (specialist, MZHETS)	35,18	23,71
KVO	35,10	22,60
Vlerësimi Total	Operatori 1 (1)	Operatori (2)
sipas specialisteve	80,18	70,81
sipas KVO	70,70	71,30

Nga auditimi dhe vlerësimi sa më sipër, u konstatua se në dokumentacionin që administrohet në dosjen e procedurës në vlerësimin përfundimtar që ka bërë KVO-ja, nuk janë argumentuar diferencat në pikë, ndaj vlerësimit të specialistëve të fushës.

Sipas kërkesave të VKM nr 646, datë 22.07.2017 “Për përcaktimin e procedurave e të kriterëve të përzgjedhjes së zhvilluesit ekonomik në zonën e teknologjisë dhe të zhvillimit ekonomik” neni 11, përcaktohet se “...Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të zbatojë detyrat e tij në pavarësi të plotë...”. Fakti që vlerësimi i KVO-së ndryshon nga ai i specialistëve, tregon për vlerësime të pambështetura në ekspertizën e fushës.

Rëndësia e rolit të specialistëve të fushës në përbërje të KVO-së shprehet qartë edhe në relacionin e paraqitur nga Juristi i institucionit, më datë 04.07.2017, ditën e zhvillimit të procedurës konkurruese, ku cilësohet se:

“Për sa i përket vlerësimit teknik, mjedisor dhe financiar, në kushtet kur për pikëzimin e këtyre kriterëve kërkohen njohuri të veçanta të fushave përkatëse, mbetem i rezervuar në dhënien e mendimit tim si anëtar i KVO, meqenëse unë i përkas fushës juridike dhe nuk jam specialist për vlerësimin e tyre. Në këto kushte, kur kërkohet pikëzimi nga çdo anëtar komisioni, në përmbushje të detyrës së ngarkuar si anëtar i KVO-së, sqaroj se pikëzimi i dhënë nga ana ime, është i orientuar nga pikët e dhëna nga specialistet e fushave përkatëse”.

2.2 Nga verifikimi i kryer në dosjen e kësaj procedure u konstatua se, 4 nga 9 anëtarë të KVO-së, në cilësinë e specialistëve të fushës kanë bërë vlerësime në mënyrë të pavarur me pikë, për secilin kriter konkurrues.

Në vijim, verbalisht KVO pretendon se për vlerësimin total ka marrë në konsideratë mesataren e thjeshtë matematikore të vlerësimeve individuale të specialistëve të fushës, për të cilën grupi i auditimit kreu përlllogaritjet, nga ku rezultoi se edhe ky pretendim nuk qëndron. Nga përlllogaritjet e grupit të auditimit rezultoi se, vlerësimi mesatar me pikë për “Operatori 2” është 71.33 pikë dhe për Operatori 1 është 74,48 pikë (ose 3.15 pikë më shumë), duke renditur përsëri në vend të parë shoqërinë “Operatori 1” shpk.

Njësia “pikë”

Nr	Emri i anëtarit të KVO	“Operatori 2”	“Operatori 1”
1	Kryetari i KVO-së	-	-
2	Anëtar 1	72.81	68.18
3	Anëtar 2	-	-
4	Anëtar 3	72.81	68.18
5	Anëtar 4	66.90	93.40
6	Anëtar 5	-	-
7	Anëtar 6	72.81	68.18
8	Anëtar 7	-	-
9	Anëtar 8	-	-
	Totali	285.33	297.94
	Vlerësimi mesatar me pikë *	71.33 (285.33 pikë /4)	74.48 (297.94 pikë/4)

* Përlllogaritjet janë kryer nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga sa më sipër konstatohet se, 3 nga këta 4 anëtarë (konkretisht punonjës të MZHETS), rezultojnë të kenë vlerësuar me pikë të njëjta shoqërinë “ Operatori 2” (72.81 pikë) dhe Operatori 1 (68.18 pikë). Ndërsa përfaqësuesi i AIDA-s ka vlerësuar me 66.9 pikë shoqërinë “Operatori 2”, dhe 93.4 pikë shoqërinë “Operatori 1”.

Për këtë rekomandoj:

Në çdo rast të vlerësohen dhe merren në konsideratë pikëzimet e specialistëve të fushës, si personat që kanë ekspertizën e duhur në fushat respektive.

Menjëherë dhe në vazhdim

3. Nga auditimi mbi vlerësimet e kriterëve, të përcaktuara në dokumentet e procedurës u konstatuan të meta dhe mangësi, konkretisht:

Për kriterin 1 “Propozimi teknik për ndërtimin e zonës”, kanë dhënë opinione dhe janë shprehur me raporte individuale dy prej specialistëve të fushës në cilësinë e anëtarëve të KVO-së, respektivisht:

a. Anëtari i KVO përfaqësues i AIDA, i cili sipas kërkesave të KVO ka paraqitur relacionin shpjegues në lidhje me vlerësimin e ofertave teknike për çdo operator ekonomik, e konkretisht: -“Kompania “Operatori 1” ka parashikuar një shfrytëzim më të mirë të sipërfaqes kryesisht me veprimtari prodhuese të industrisë së lehtë dhe magazinë doganore, të cilat janë tipike për këtë zonë.

-Kompania bashkimi i operatorëve ekonomikë “X. & “Y” & “Z”, parashikon nga ana estetike një projekt më të bukur (kështu duket nga vizatimet e projektit shënim nga anëtari i KVO-së), pasi ka futur teknologjinë e paneleve diellore, por nga ana tjetër në këtë zonë fut edhe teknologjinë e rënde, që në rastin konkret është uzinë Ferro-Kromi, e cila krijon disavantazhe në kuptimin e ndotjes së ambientit”.

Operatori ekonomik “Operatori1” ka avantazh pasi nuk përdor industrinë e rënde, krijon pak ose aspak ndotje mjedisore në krahasim me kompaninë tjetër e cila krijon disa lloj ndotjesh si; çlirim të gazrave, pluhurash të dëmshëm, ndotje akustike si dhe mbetje në formë skorie.

Në përfundim z. A paraqet vlerësimin individual me pikë të operatorëve ekonomikë sipas tabelës së mëposhtme:

Zëri i projektit	Kriteri 1 Propozimi teknik për ndërtimin e zonës	Vlera max pikë 25	Klasifikimi OE	
			Edil-Alit 24	Pelikan 23
	a	Projekt ide	2	2
b	Teknologjia	4	3	4
c	Cilësia e infrastrukturës	5	5	5
d	Plani teknik dhe inxhinierik	5	5	5
e	Plani operacional	3	3	2
f	Plani i marketingut	4	4	4
g	Llojet e aktivitetit	2	2	1

Sipas tabelës së mësipërme dhe relacionit të paraqitur një anëtar i KVO, i cili analizon treguesit për çdo zë të këtij kriteri, duke vlerësuar me 24 pikë ofertuesin “Operatori 1” dhe kompaninë e përbërë nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “X & “Y” & “Z” me 23 pikë.

b. Në vlerësimin individual, anëtari i KVO-së, përfaqësues i ish Ministrisë së Zhvillimit Urban, pas studimit të kapaciteteve teknike në kontekstin inxhinierik për shoqërinë “Operatori 2”, deklaroi se, “në takimin e radhës do vijë me analiza të veçanta për çdo operator”. Nga verifikimi i raportit përfundimtar, u konstatua se ky anëtar nuk ka paraqitur analiza të veçanta sikundër ka pretenduar në vlerësimin fillestar.

Në raportin vlerësues të paraqitur nga ky anëtar, protokolluar në datën 04.07.2017, është bërë vlerësim i pjesshëm i kriterit “Propozim teknik i zonës”, duke vlerësuar vetëm 5 zëra të këtij propozimi nga 7 zëra gjithsej që ka ky “kriter”, të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Zëri i projektit	Propozimi teknik për ndërtimin e zonës	Vlera max. pikë	Klasifikimi OE	
			Operatori 2	Operatori 1
a	Projekt ide	2	2	1
b	Teknologjia	4	4	1
c	Cilësia e infrastrukturës	5	5	2
d	Plani teknik dhe inxhinierik	5	5	2
e	Plani operacional	3	3	1
f	Plani i marketingut	4	-	-

g	Llojet e aktivitetit	2	-	-
	Shuma	25	19	7

Nga auditimi u konstatua se, vlerësimi për “Propozimin teknik për ndërtimin e zonës”, i kryer nga z.E është i pjesshëm, pasi nuk përmban të dhëna të hollësishme mbi analizën e dokumentacionit administrativo-ligjor për t’u marrë në konsideratë nga Grupi i Auditimit të KLSH-së.

Nga tabela e mësipërme rezulton se, përfaqësuesi i ish Ministrisë së Zhvillimit Urban, propozimin teknik të paraqitur nga operatorët ekonomikë me përjashtim të dy zërave (plani i marketingut dhe llojet e aktivitetit), ka vlerësuar maksimalisht me **19 pikë** bashkimin e OE “X & Y & Z” dhe Operatorit 1 me 7 pikë. (dy zëra nuk janë vlerësuar).

Për sa më lart, vlerësimi i paraqitur nga ky anëtar është i pjesshëm, nga ku konstatojmë se KVO nuk ka kërkuar shpjegim për arsyen e mos vlerësimit të dy zërave të tjerë, për të dhënë opinionin përfundimtar, siç është përcaktuar në detyrat e komisionit të vlerësimit të ofertave.

Në përfundim të vlerësimit të këtij kriteri kualifikues konstatohet se, dy anëtarë të komisionit për të njëjtin kriter vlerësimi kanë dhënë dy opinione krejtësisht të ndryshme nga të cilët, opinionin i z.E është i pjesshëm.

Pas vlerësimit të propozimit teknik nga anëtar, përfaqësuesi i ish Ministrisë së Zhvillimit Urban, më datën 04.07.2017, ka bërë rivlerësim të propozimit teknik dhe të opinionit të paraqitur në datën 20.06.2017, duke ndryshuar opinionin me arsyetimin se: “Ky ndryshim vjen si pasojë e rishikimit të gjerë teknik, sqarimet përkatëse dhe shqyrtimin e kujdesshëm të Raportit të Anëtarit të KVO të Ministrisë së Zhvillimit Urban. Ndryshimet në pikaverazh i takon pikërisht pikës 1.c. “Cilësia e Infrastrukturës, dhe pikës 1.d. “Plani teknik dhe inxhinierik, të cilat nga 5 pikë të vlerësuara maksimalisht bëhen 3 dhe 4”, duke ulur në këtë mënyrë “Vlerësimin teknik e për ndërtimin e zonës” për shoqërinë “Operatori 1” nga 24 pikë në 21 pikë, ndërsa pikëzimi i shoqërisë “X & Y” & “Z” ose Operatori 2 mbetet i pandryshuar me 23 pikë, (raporti nr.39) të cilat paraqiten në tabelën e riformuluar si më poshtë:

Zëri i projektit	Propozimi teknik për ndërtimin e zonës	Vlera max pikë	Klasifikimi OE		
			Operatori 1	Operatori 2	Operatori 1 I ndryshuar
a	Projekt ide	2	2	2	2
b	Teknologjia	4	3	4	3
c	Cilësia e infrastrukturës	5	5	5	3
d	Plani teknik dhe inxhinierik	5	5	5	4
e	Plani operacional	3	3	2	3
f	Plani i marketingut	4	4	4	4
g	Llojet e aktivitetit	2	2	1	2
	Shuma	25	24	23	21

Nga tabela e mësipërme konstatohet, pas rivlerësimit, nga anëtari i KVO në cilësinë e inxhinierit të ndërtimi dhe përfaqësuesi i AIDA, ka ulur vlerësimin për propozimin teknik të OE “Operatori 1” nga 24 pikë në 21 pikë

Nga verifikimi i kryer konstatohet se, edhe ky ndryshim i bërë për këtë kriter nga ky anëtar nuk është marrë në konsideratë nga KVO, në vlerësimin përfundimtar sipas kriterëve të përcaktuara në dokumentet e zhvillimit të kësaj procedure. Sipas tabelës përfundimtare të nënshkruar nga KVO, vlerësimi i “Propozimi teknik për ndërtimin e zonës” për shoqërinë “Operatori 2” është llogaritur me 24.8 pikë dhe shoqëria “Operatori 1” është vlerësuar me 9

pikë, nga 21 pikë që ka vendosur në relacionin e paraqitur nga z. X, duke ulur pikëzimin e ofertuesit “Operatori 1” me 12 pikë më pak.

Për këtë rekomandoj:

Strukturat përgjegjëse të marrin masa, duke përcaktuar në dokumentet e procedurave të dhënies me qira apo koncesion të pasurisë publike, përcaktime sqaruese mbi shkallën e argumentimit për specialistët e fushës, në mënyrë që vlerësimet individuale të ekspertëve të shërbejnë si bazë për KVO, për vlerësimin përfundimtar të operatorëve në garë.

Në vazhdim

Për Kriterin 2 “Ndikimi Mjedisor”:

Nga auditimi u konstatua se, në vlerësimin e përfaqësueses së Ministrisë së Mjedisit, ka munguar argumentimi specifik për vlerësimin e secilit operator, sa i takon kriterit të ndikimit mjedisor, duke i dhënë bashkimit të operatorëve ekonomikë “X & Y” & “Z” ose Operatori 2” maksimumin e pikëve, prej 10 pikësh (vlerësim i cili është marrë për bazë në llogaritjen përfundimtare nga komisioni), sipas tabelës së mëposhtme:

Kriteri	Emërtimi i zërave të kriterit	Vlera max pikë	Klasifikimi OE	
			Operatori 2	Operatori 1
2	Ndikimi Mjedisor	10	10	4
b	Masat për ndikimin minimal mjedisor	5	5	2
c	Lloji i aktivitetit sipas studimit	5	5	2

Në përfundim të vlerësimit të kriterit “Ndikimi në mjedis”, përfaqësuesja e Ministrisë së Mjedisit ndonëse për të dy operatorët ekonomikë është shprehur me rezerva të konsiderueshme për ndikimin mjedisor, ka formuluar konkluzionet përfundimtare për këto shoqëri me paragrafin e mëposhtëm:

“...identifikimi i ndikimeve në tërësi në komponentët e mjedisit nga zbatimi i planit të propozuar është kryer në mënyrë sipërfaqësore dhe nuk shprehen qartë se cilat do të jenë këto ndikime, rrjedhimisht edhe masat e propozuara në këtë raport për shmangien apo minimizimin e ndikimeve në mjedis”. Në përfundim të raportit të saj, *përfaqësuesja e Ministrisë së Mjedisit* rekomandon që, “*Në kontratën e lidhur me ofertuesin fitues të vihet si kusht kryerja e studimit të vlerësimit Strategjik Mjedisor për zonën në tërësi, si dhe zhvillimi i procedurave të vlerësimit të ndikimit në Mjedis për çdo projekt të propozuar në këtë zonë*”.

Grupi i auditimit konstatoi se, rekomandimi i përfaqësueses së Ministrisë së Mjedisit konsiderohet formal, pasi në këtë raport, krahas ndikimit mjedisor duhej të përcaktoheshin edhe masa konkrete për shmangien apo minimizimin e ndikimeve në mjedis, për secilin projekt të propozuar në këtë zonë, të cilat duhet të ishin bërë pjesë e draft-kontratës.

Si pasojë e konkluzioneve të specialistes së fushës, operatori që do të ndërtojë fabrikën e ferrokromit është vlerësuar me pikë maksimale për kriterin mjedisor, ndonëse vetë përfaqësuesja e Ministrisë së Mjedisit e ka cilësuar këtë investim me impakt negativ në mjedis (ndotje mjedisore).

Nga auditimi u konstatua se, ndonëse specialistja e fushës ka formuluar në mënyrë identike konkluzionet për të dy operatorët mbi ndikimin mjedisor, vlerësimi me pikë për secilin prej tyre është bërë i ndryshëm, në mënyrë subjektive dhe të paargumentuar, duke favorizuar ndjeshëm bashkimin e operatorëve ekonomikë “X & Y & Z”, me 10 pikë dhe operatorin ekonomik “Operatori 1” me 4 pikë.

Më konkretisht:

a. Për raportin e operatorit “Operatori 1”, përfaqësuesja e ish Ministrisë së Mjedisit shprehet se: “Raporti përmban disa akte ligjore të shfuqizuara. Aktivitetet që janë propozuar në këtë zonë janë të detajuara dhe të qarta, si pasojë edhe ndikimi që ato mund të sjellin gjatë ndërtimit apo operimit të tyre nuk del në pah dhe nuk mund të propozohen masa konkrete për minimizimin e ndotjes”. Gjithashtu në brendësi të raportit theksohet se, “në këtë propozim nuk janë planifikuar struktura dhe biznese që shkaktojnë ndotje të mjedisit”, ndërkohë që në propozim shprehet se “do kemi edhe një strukturë për përpunimin e metaleve², apo edhe një strukturë për trajtimin e mbetjeve³”.

b. Për raportin⁴ e bashkimit të operatorëve ekonomikë “X & Y” & “Z”, specialistja është shprehur se, “është i strukturuar sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis, por identifikimi i ndikimeve në tërësi në komponentët e mjedisit nga zbatimi i planit të propozuar është kryer në mënyrë sipërfaqësore dhe nuk shprehen qartë se cilat do të jenë këto ndikime, rrjedhimisht edhe masat e propozuara për shmangien apo minimizimin e ndikimeve në mjedis janë të paqarta”.

Në këtë raport nuk u gjend asnjë e dhënë për llojin e gazrave që do të çlirohen nga përpunimi i mineralit dhe mënyrat për minimizimin nga ndotja e mjedisit përreth saj.

Nën gjykimin e grupit të auditimit, mendimi i shprehur nga specialistja e mjedisit është kontradiktor dhe me dy standarde pasi në fillim të mendimit të saj cilëson se:

-“identifikimi i ndikimeve në tërësi në komponentët e mjedisit nga zbatimi i planit të propozuar është kryer në mënyrë sipërfaqësore dhe nuk shprehen qartë se cilat do të jenë këto ndikime, rrjedhimisht edhe masat e propozuara në këtë raport për shmangien apo minimizimin e ndikimeve në mjedis”; ndërsa në përfundim të relacionit për instalimin e ferrokromit shprehet se:

- “ky raport ndalet kryesisht në ndikimet që do të ketë një nga projektet me ndikimin më të madh në mjedis në këtë propozim, siç është instalimi i ferro-kromit. Për këtë instalim është dhënë një informacion i detajuar, janë identifikuar ndikimet kryesore në mjedis dhe janë propozuar masat për minimizimin e ndotjes”.

Në relacionin e paraqitur nga përfaqësuesja e Ministrisë së Mjedisit duhej të përcaktoheshin masa konkrete për eliminimin e mbetjeve në formë skorie, që do dalin nga përpunimi i uzinës së “Ferro-kromit”, e cila sjell ndotje të konsiderueshme mjedisore.

Në relacionin e vlerësimit të “Ndikimit mjedisor”, nuk u gjend asnjë analizë mbi teknologjinë e ofruar që do përdoret për përpunimin e mineralit, nuk janë kërkuar të dhëna për normat e mundshme të ndotjes së mjedisit, çfarë pajisje do të përdoren për minimizimin e ndotjes së mundshme mjedisore, e sidomos të gazrave nga përpunimi i “ferro-kromit”, shkalla e ndotjes akustike dhe masat e marra për minimizimin e saj.

Në përfundim, konkludojmë se nga ana e përfaqësueses së Ministrisë së Mjedisit nuk del qartë mënyra e vlerësimit me pikë për “Kriterin e mjedisit”, i cili rezulton të jetë vlerësuar maksimalisht për bashkimin e operatorëve ekonomikë, pa marrë në konsideratë ndotjen mjedisore dhe eliminimin e skorieve, si nënprodukt i fabrikës së “ferro-kromit” që ky operator parashikon të ndërtojë.

Në kuadër të Direktivës 2006/21 të Komisionit Evropian “Mbi Mbeturinat Minerare” gjejmë një vlerësim të detajuar të risqeve që mbart prodhimi i kromit si: risqe që lidhen me çlirimin e toxinave të kromit (Cr) në mjedis, apo risqe nga materialet ndihmëse në prodhim si alumini

² e cila nuk detajohet

³ për të cilën nuk ka informacion

⁴ Sipas raportit nr. 40 datë 04.07.2017, të anëtares së KVO, në cilësinë e përfaqësueses së Ministrisë së Mjedisit, zj. Ornela Shoshi

(për procese aluminotermike), etj. Nga auditimi u konstatua se këto risqe me impakt të lartë në mjedis, nuk janë trajtuar në asnjë relacion të vënë në dispozicion grupit të auditimit. Në vijim Direktiva parashikon edhe një sërë masash për të minimizuar këto risqe mjedisore.

Për këtë rekomandoj:

Nga strukturat përgjegjëse, të merren masa për të përcaktuar qartë në dokumentat e procedurave të dhënies me qira apo koncesioneve të pronës publike, mënyrat e vlerësimit të kriterit mjedisor si një element i rëndësishëm me ndikim të lartë në mjedis dhe si pasojë edhe në cilësinë e jetës. Në relacionet mbi vlerësimet e ndikimeve mjedisore, nevojitet që nga ana e ekspertëve të fushës, të renditen risqet konkrete që mbartin projektet në mjedis si dhe masat e nevojshme në funksion të mbrojtjes së mjedisit.

Në vazhdim

Për kriterin nr. 3, “Ndikimi social”

Nga verifikimi i dokumentacionit të kësaj procedure, nuk u gjend asnjë relacion apo raport përfundimtar, mbi zhvillimin e seancave informuese, diskutimeve dëgjuese me komunitetin e zonës, mbi rëndësinë e zhvillimit të zonës së Spitalllës, efektet e ndikimit social, përfitimet dhe impakti që do të ketë kjo zonë nga investimet e kryera.

Në vijim, nga auditimi u konstatua se, KVO për përllogaritjen e pikëve për kriterin “ndikimi social”, më konkretisht “Numri i të punësuarve”, për bashkimin e operatorëve ekonomikë “X & Y” & “Z”, ka marrë me pa të drejtë në konsideratë numrin prej 3,250 punonjës, dhe jo numrin e të punësuarve sikundër paraqitet në ofertë prej 2,500 punonjës⁵. **Sa më sipër ka rritur artificialisht vlerësimin me pikë për këtë bashkim operatorësh.**

Nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga shoqëria “X & Y” & Z” ose “Operatori 2” konstatohet se, oferta e paraqitur për numrin e të punësuarve është 2,500 punonjës dhe se gjatë zhvillimit të fazave të tjera mund të shtohet numri i të punësuarve edhe me 30 % punonjës të tjerë. Formulimi i kësaj oferte është në kundërshtim me dokumentet standarde të procedurës, pasi në kriteret e vlerësimit, pika 1 “oferta” është përcaktuar se “Ofertuesi duhet të paraqesë vetëm një ofertë”. Për sa më sipër formula për numrin e “Fuqisë punëtore” duhet të ishte llogaritur mbi bazën e ofertës zyrtare dhe jo mbi bazën e të dhënave të tjera, alternativë të ofertës.

Nga rivlerësimi i këtij kriteri nga grupi i auditimit të KLSH-së, rezultoi se duke zbatuar formulën e përcaktuar në kriteret e vlerësimit, tashmë mbështetur mbi numrin prej 2,500 punonjësish (të përcaktuar në ofertë) dhe jo 3,250 (sikurse ka ndodhur) **pikëzimi për bashkimin e operatorëve “X & Y” & Z”, nga 2.7 pikë, të ulet në 2.08 pikë.**

Kriteri 4 “Koha e përfundimit”.

Nga auditimi për vlerësimin e këtij kriteri⁶ rezultoi se, është vlerësuar me 6.4 pikë bashkimi i operatorëve ekonomikë “Operatori 2”, dhe me 10 pikë shoqëria “Operatori 1” (nga maksimumi 10 pikë).

Nga verifikimi i kryer në dokumentacionin administrativ ligjor të bashkimin e operatorëve ekonomikë “Operatori 2” (studimi i fizibilitetit) konstatohet se, të dhënat financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe gjithë të dhënat e tjera janë llogaritur sipas tabelës së përfundimit të investimit, që janë parashikuar të përfundojnë në fund të vitit 2032, çka do të thotë se periudha e përfundimit të objektit do të jetë **15 vjet dhe jo 12.5 vjet** sikundër është përcaktuar në ofertë dhe si pasojë mbi këtë bazë është bërë dhe vlerësimi i kriterit në fjalë (në

⁵ Numri prej 3,250 punonjësish është alternativë e ofertës së operatorit, pasi oferta ka përcaktuar 2,500 punonjës

⁶ Në referencë të raportit nr. 41, nga anëtari i komisionit, Stefan Koçollari, si përfaqësues i MZHETS.

formulë llogaritjet janë bërë për afatin 12,5 vjet (ose 150 muaj) dhe jo 15 vjet (ose 180 muaj⁷) që është koha e përfundimit sipas studimit të fizibilitetit dhe grafikut të punimeve).

Sa më sipër konkludojmë se, për kriterin “koha e përfundimit”, bashkimi i operatorëve ekonomikë “X & Y” & “Z” ose “Operatori 2” është vlerësuar nga KVO gabim me 6.4 pikë, pasi nga rivlerësimi që grupi i auditimit i bëri këtij kriteri, duke konsideruar periudhën e përfundimit 180 muaj (dhe jo 150), bashkimi i operatorëve duhej të vlerësohej me 5.33 pikë (ose 1.07 pikë më pak) dhe jo 6.4 sikundër është vlerësuar.

Konkluzion.

Grupi i auditimit në përfundim, rivlerësoi kriteret duke marrë në konsideratë:

1. vlerësimet e specialistëve të fushës për kriteret respektive; dhe
2. korrigjimin e gabimeve në formulat për kriteret: “numri i të punësuarve”, dhe “kohëzgjatja e përfundimit të investimit”,

Nga rivlerësimi u konstatua se, Operatori 1 duhej të ishte vlerësuar me 80.18 pikë dhe Operatori 2 me 69,12 pikë (ose 11.06 pikë më pak se Operatori 1), duke ndryshuar edhe renditjen e këtyre operatorëve. Tabela në vijim paraqet vlerësimet sipas KVO-së dhe sipas grupit të auditimit të KLSH-së:

Kriteri	Emërtimi i zërave të kriterit	Vlera max pikë	Operatori 2		Operatori 1	
			KVO	KLSH	KVO	KLSH
1	Propozimi teknik për ndërtimin e zonës	25	24,80	23,00	10,30	21,00
2	Ndikimi Mjedisor	10	9,70	10,00	4,70	4,00
3	Ndikimi Social	15	7,70	7,08	10,60	10,00
4	Koha e përfundimit	10	6,50	5,33	10,00	10,00
5	Kapaciteti financiar	40	22,60	23,71	35,10	35,18
Totali pikë		100	71,3	69,12	70,7	80,18

Klasifikimi i gabuar i operatorit ekonomik “Operatori 1 në vend të dytë, sjell si pasojë:

- potencialisht 54 milionë Euro investime të munguara (kosto e investimit të Operatori 1 është rreth 93 milionë Euro, ndërsa e bashkimit të operatorëve Operatori 2 është 39 milionë Euro, ose 54 milionë Euro më pak);
- potencialisht 9,500 vende pune më pak (Operatori 1 do të punësojë 12,000 punëtorë, ndërsa e bashkimi i operatorëve Operatori 2, 2,500 punonjës);
- potencialisht të ardhurat e munguara në buxhetin e shtetit, nga mos realizimi i kontributeve për pagesën e sigurimeve shoqërore vetëm për 1 vit për shumën **718 milionë lekë** (6,300 x 9,500 x 12); dhe së fundmi
- Risqe të shtuara për ndotjen mjedisore (Operatori 1 do të investojë në magazina doganore, qendra biznesi, etj; ndërsa bashkimi i operatorëve Operatori 2, midis të tjerash do të investojë edhe në ndërtimin e një fabrike ferrokromi, me impakt të lartë mjedisor)

Për këtë rekomandoj:

a. Duke konsideruar të parregullta procedurat e përzgjedhjes së zhvilluesit të zonës teknologjike të zhvillimit ekonomik në Spitalë, Durrës, dhe si pasojë edhe rezultatin

⁷ Në referencë të faqes 33 të studimit të fizibilitetit.

përfundimtar të renditjes së operatorëve ekonomikë, rekomandojmë anulimin e procedurës së vlerësimit të ofertave.

b. Në rast se konstatohet që, gjatë periudhës së përgatitjes së këtij Raporti Përfundimtar Auditimi, është lidhur kontrata me bashkimin e operatorëve ekonomikë “X&Y, Z”, ose “Operatori 2” të ndërmerren masa ligjore për anulimin e kontratës sipas kushteve të përcaktuara në kodin civil.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE.

Për Komisionin e Vlerësimit të Ofertave: bazuar në shkeljet e konstatuara e të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandojmë titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për vlerësimin e shkeljeve të konstatuara dhe marrjen e masës disiplinore deri në largim nga puna, respektivisht për:

1. Kryetarin e KVO, përfaqësues i ish Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.
2. Anëtarin e KVO, përfaqësuese e ish Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.
3. Anëtarin e KVO-së përfaqësues i ish Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.
4. Anëtarin e KVO-së përfaqësues i ATRAKO,
5. Anëtarin e KVO-së përfaqësues i Ministrisë së Financave,
6. Anëtarin e KVO, përfaqësuese e ish Ministrisë së Mjedisit,

E. KALLËZIM PENAL

Lidhur me mangësitë e konstatuara më sipër, trajtuar më hollësisht edhe në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për procedurën e përzgjedhjes së zhvilluesit të zonës teknologjike të zhvillimit ekonomik në Spitallë, Durrës, të vlerësohet nga Departamenti Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe të shërbejë si indicie për kallëzim penal për personat e mëposhtëm:

1. Kryetarin e KVO, përfaqësues i ish Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.
2. Anëtarin e KVO, përfaqësuese e ish Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.
3. Anëtarin e KVO-së përfaqësues i ish Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.
4. Anëtarin e KVO-së përfaqësues i ATRAKO,
5. Anëtarin e KVO-së përfaqësues i Ministrisë së Financave,
6. Anëtarin e KVO, përfaqësuese e ish Ministrisë së Mjedisit,

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R